



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 59/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 26.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj ashtu që Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2000 (dymijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për të u dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 25.04.2012, nga LVV, me të cilën pretendohet se më datën 24.04.2012 në ora 17:00, në rrugën “13 Qershori”, në Ferizaj, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, anëtarët e subjektit politik PDK, kanë mbuluar posterët e kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt nga radhët e LVV-së Faton Topalli, me posterët e kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt nga radhët të subjektit politik të PDK-së, Agim Aliu, sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e nenit 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 , i *Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa foto që dëshmojnë shkeljen e *Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK, më datë 25.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 26.04.2012 në ora 12:00, sipas kohës së përcaktuar PZAP-i, nuk ka pranuar përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

ankesa është e bazuar.

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posteri i kandidatit për kryetar të komunës në Ferizaj nga radhët e subjektit politik PDK, është vendosur mbi posterin e kandidatit për kryetar të komunës në Ferizaj nga radhët e LVV-së. Prandaj nga këto arsye dhe me qëllim të evitimit të shkeljeve të lartcekura, po ashtu në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 59/2012 më datën 26.04.2012

